1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
  2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
    - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
    - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
    - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
    - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;
- Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial.....

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike .....

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit .....

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**  
(në rast BOE): \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					

---

<b>Nëshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

**Shtojca 5.**

*(<sup>6</sup>Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)*

**DEKLARATË**

**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**

---

<sup>6</sup> Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

---

## Shtojca 6 .

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Shërbimi i dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit ka për qëllim ruajtjen e kushteve optimale higjieno-sanitare në ambientet ku ushtron veprimtarinë shoqëria "Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit" sha, parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së mikroorganizmave patogjenë, insekteve dhe brejtësve, si dhe mbrojtjen e shëndetit të personelit dhe përdoruesve të ambienteve.

#### 1. Dezinfektimi i ambienteve të brendshme.

Shërbimi konsiston në kryerjen e dezinfektimit të ambienteve të brendshme dhe të mbyllura të objekteve në administrim të shoqërisë "Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit" sha, me qëllim reduktimin ose eliminimin e mikroorganizmave patogjenë dhe garantimin e kushteve të përshtatshme higjieno-sanitare.

Shërbimi do të kryhet në të gjitha ambientet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: zyrat administrative, Centralët e Sterilizimit, tualetet, magazina, arkiva dhe çdo ambient tjetër funksional që, bazuar në nevojat operacionale dhe vlerësimin e riskut higjieno-sanitar, kërkon trajtim dezinfektues.

---

Dezinfektimi duhet të realizohet me produkte BIOCIDE të autorizuar për vendosje në treg dhe përdorim në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në krah të fushës (Ligji Nr. 95/2015, "Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik", i ndryshuar, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 933, datë 25.11.2020, "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg"). Përdorimi i produkteve do të kryhet sipas udhëzimeve të prodhuesit, protokolleve higjieno-sanitare në fuqi dhe rregullave për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, duke garantuar vijueshmërinë e aktivitetit normal të institucionit dhe sigurinë e personelit dhe përdoruesve të ambienteve.

## **Të dhënat teknike të produkteve biocide për dezinfektimin e ambienteve të brendshme**

Shërbimi i dezinfektimit të ambienteve të brendshme do të realizohet me produkte BIOCIDE të autorizuar për përdorim në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse. Produktet biocide që do të përdoren duhet të jenë të përfshira në listën e produkteve të miratuara nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ose të disponojnë autorizimet përkatëse të vlefshme, sipas legjislacionit në fuqi.

Produktet biocide duhet të jenë të destinuar **për përdorim profesional** dhe të përshtatshme për aplikim në ambiente të brendshme. Produktet e përdorura duhet të kenë spektër veprimi të përshtatshëm për qëllimin e dezinfektimit, në përputhje me karakteristikat teknike të deklaruara nga prodhuesi dhe dokumentacionin teknik shoqëruar, duke garantuar efektivitetin ndaj mikroorganizmave për të cilët janë të destinuar, përfshirë, sipas rastit, veprimin baktericid, fungicid dhe virusicid.

Produktet biocide duhet të përdoren në përputhje me fletët teknike (Technical Data Sheet - TDS), fletët e të dhënave të sigurisë (Safety Data Sheet - SDS) dhe udhëzimet e prodhuesit, duke respektuar kërkesat për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, të kafshëve, të mjedisit dhe rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë. Nuk lejohet përdorimi i produkteve ose preparateve të paautorizuara, të skaduar ose që nuk janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për produktet biocide dhe mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit.

Shpeshësia e kryerjes së shërbimit do të jetë **3 (tre) herë në vit**, sipas planifikimit të Autoritetit Kontraktor. Në raste të veçanta, të lidhura me nevoja operacionale, situata epidemiologjike ose vlerësime të riskut higjieno-sanitar, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kërkojë ndërhyrje shtesë, brenda fondit limit dhe sasive të parashikuara.

## **2. Dezinfektimi i ambienteve të jashtme.**

Shërbimi konsiston në kryerjen e dezinfektimit të ambienteve të jashtme dhe të hapura të objekteve në administrim të Autoritetit Kontraktor, me qëllim ruajtjen e kushteve të përshtatshme higjieno-sanitare dhe minimizimin e rrezikut të përhapjes së agjentëve biologjikë në zonat me qarkullim të personelit dhe vizitorëve.

Shërbimi do të realizohet në të gjitha ambientet e jashtme të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: holle të hapura, sheshe pushimi, ambiente

---

pritjeje të jashtme, rrugica hyrëse dhe dalëse, mure të jashtme të godinave, mure rrethuese, zona të aksesit dhe çdo sipërfaqe tjetër funksionale që, bazuar në nevojat operacionale dhe vlerësimin e riskut higjieno-sanitar, kërkon trajtim dezinfektues.

Dezinfektimi i ambienteve të jashtme duhet të kryhet me produkte biocide të autorizuara për përdorim në Republikën e Shqipërisë, të përshtatshme për aplikim në ambiente të hapura dhe në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi, udhëzimet e prodhuesit dhe rregullat për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, mjedisit dhe sigurisë në punë. Metodrat dhe teknikat e aplikimit duhet të garantojnë efektivitetin e trajtimit, duke shmangur dëmtimin e sipërfaqeve të trajtuara, ndotjen e mjedisit ose krijimin e rrezikut për personelin, vizitorët dhe organizmat joshënjestër.

### **Të dhënat teknike të produkteve BIOCIDË për dezinfektimin e ambienteve të jashtme**

Produktet duhet të jenë të përfshira në listën e produkteve biocide të miratuara nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ose të disponojnë autorizimet përkatëse të vlefshme, sipas legjislacionit në fuqi.

Produktet biocide duhet të jenë të destinuara për përdorim profesional dhe të përshtatshme për aplikim në ambiente të jashtme, bazuar në vlerësimin e riskut higjieno-sanitar, kërkon trajtim dezinfektues.

Produktet e përdorura duhet të kenë spektër veprimi të përshtatshëm për qëllimin e dezinfektimit, në përputhje me karakteristikat teknike të deklaruara nga prodhuesi dhe dokumentacionin teknik shoqërues, duke garantuar efektivitet ndaj mikroorganizmave për të cilët janë të destinuara, përfshirë, sipas rastit, veprimin baktericid, fungicid dhe virusicid. Aplikimi i tyre duhet të kryhet në përputhje me fletët teknike (Technical Data Sheet - TDS), fletët e të dhënave të sigurisë (Safety Data Sheet - SDS) dhe udhëzimet e prodhuesit.

Nuk lejohet përdorimi i produkteve ose preparateve të paautorizuara, të skaduara ose që nuk janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për produktet biocide dhe mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit. Gjatë zbatimit të shërbimit, operatori ekonomik duhet të sigurojë që produktet dhe metodat e përdorura të mos krijojnë rrezik të pajustificuar për shëndetin e njerëzve, organizmave joshënjestër dhe mjedisit, duke respektuar masat e sigurisë të përcaktuara nga prodhuesi dhe legjislacioni përkatës.

Shpeshësia e kryerjes së shërbimit do të jetë 3 (tre) herë në vit, sipas planifikimit të Autoritetit Kontraktor. Në raste të veçanta, të lidhura me nevoja operacionale, situata epidemiologjike, kërkesa të Autoritetit Kontraktor ose vlerësime të riskut higjieno-sanitar.

### **3. Shërbime dezinfektimi dhe deratizimi.**

Shërbimi i dezinfektimit do të kryhet me produkte biocide insekticide të destinuara për luftimin e insekteve zvarritëse, fluturuese, akarideve dhe artropodëve të tjerë me rëndësi higjieno-sanitare. Insekticidet që do të përdoren duhet të jenë të autorizuara për përdorim në Republikën e Shqipërisë, të destinuara për përdorim profesional dhe të përshtatshme për kontrollin e insekteve vektore të transmetimit të sëmundjeve me origjinë virale dhe bakteriale.

---

Shërbimi i dezinfektimit të hapësirave të jashtme kundër mushkonjave do të realizohet nëpërmjet aplikimit të insekticidit adulticid me metodën e spërkatjes me pompë në hapësirat e gjelbëruara, muret rrethuese dhe sipërfaqe të tjera të identifikuar si zona me risk. Aplikimi do të kryhet në orët e mëngjesit ose në orët e vona të mbrëmjes, në mënyrë që të minimizohet ekspozimi i njerëzve dhe ndikimi mbi organizmat joshënjestër. Insekticidi që do të përdoret duhet të jetë piretroid me bazë deltametrine, ndërsa shërbimi i dezinfektimit kundër mushkonjave do të kryhet sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, bazuar në vlerësimin e situatës dhe nivelit të infestimit.

Për kontrollin e insekteve zvarritëse në ambientet e zyrave, magazinave, centraleve të sterilizimit dhe ambienteve të tjera funksionale, Ofruesi i Shërbimit do të zbatojë një sistem monitorimi nëpërmjet vendosjes së stacioneve monitoruese dhe aplikimit të produkteve biocide të përshtatshme për këtë qëllim. Për realizimin e këtij shërbimi do të përdoren produkte biocide Neuro Nikotinoide me lëndë aktive imidacloprid. Shërbimi i kontrollit të insekteve zvarritëse do të ofrohet gjatë gjithë periudhës së vitit, me një frekuencë minimale prej një (1) ndërhyrjeje në muaj ose sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, në varësi të organizimit të shërbimit dhe nevojave operacionale.

Shërbimi i kontrollit kundër brejtësve (deratizimi) do të realizohet nëpërmjet vendosjes së stacioneve të monitorimit dhe stacioneve të aplikimit të karremit. Stacionet e karremit do të vendosen në distanca orientuese prej 10–20 metrash, në varësi të konfigurimit dhe karakteristikave të ambienteve objekt trajtimi, dhe duhet të jenë të përbëra prej materiali plastik polipropileni ose material tjetër ekuivalent me rezistencë dhe funksionalitet të ngjashëm, të përshtatshëm për vendosjen dhe mbrojtjen e karremeve rodenticide antikoagulante, me qëllim shmangien e konsumimit aksidental nga njerëzit.

Shërbimi i kontrollit kundër brejtësve (deratizimi) do të kryhet minimalisht një (1) herë në muaj, ndërsa monitorimi dhe rimbushja e kutive të karremit do të kryhen çdo 14 (katërmëdhjetë) ditë ose sipas nevojës, në rast se konstatohet prezencë e shtuar e brejtësve ose konsum i karremeve ose sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, në varësi të organizimit të shërbimit dhe nevojave operacionale.

Preparatet dhe produktet biocide që do të përdoren gjatë realizimit të shërbimit nuk duhet të krijojnë rrezik të pajustificuar për shëndetin e njerëzve, duke pasur parasysh se trajtimet do të kryhen në ambiente me aktivitet të vazhdueshëm njerëzor. Përdorimi i tyre duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, autorizimet përkatëse, udhëzimet e prodhuesit dhe kërkesat për mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit.

Pas përfundimit të çdo ndërhyrjeje, Ofruesi i Shërbimit duhet të pajisë Autoritetin Kontraktor me Certifikatën DDD, si dhe me procesverbalin e shërbimit të kryer, në të cilin duhet të pasqyrohen të paktën: data dhe vendi i ndërhyrjes, ambientet dhe sipërfaqet e trajtuara, produktet biocide të përdorura, lëndët aktive, sasia ose norma e aplikimit, stacionet e monitorimit dhe të karremit të vendosura, si dhe çdo e dhënë tjetër teknike e nevojshme për verifikimin dhe gjurmueshmërinë e shërbimit.

### **Preparatet për dezinfektim**

Për këtë qëllim, preparati biocid që do të përdoret për dezinfektimin duhet të jetë i autorizuar për përdorim në Republikën e Shqipërisë, i destinuar për përdorim profesional

---

dhe i përshtatshëm për aplikim në ambiente me aktivitet të vazhdueshëm njerëzor. Produkti duhet të disponojë dokumentacionin teknik përkatës dhe të përdoret në përputhje me udhëzimet e prodhuesit, fletën teknike të produktit (Technical Data Sheet - TDS) dhe fletën e të dhënave të sigurisë (Safety Data Sheet - SDS).

Duke marrë në konsideratë karakteristikat dhe kërkesat specifike të shërbimit objekt prokurimi, lënda bazë aktive e preparatit duhet të përbëhet nga komponime të amonit kuaternar, konkretisht:

- Benzyl-C12-16-alkyldimethyl chlorides (CAS No. 68424-85-1) në përqindje 15%–30%;
- Didecyldimethyl Ammonium Chloride (CAS No. 7173-51-5) në përqindje 5%–15%;
- Glutaraldehyde (CAS No. 111-30-8) në përqindje 5%–15%;
- si dhe përbërës të tjerë ndihmës, sipas formulimit dhe karakteristikave teknike të produktit.

Preparati duhet të garantojë efektivitetin e kërkuar dezinfektues në përputhje me karakteristikat e deklaruara nga prodhuesi dhe të jetë i përshtatshëm për përdorim në ambientet objekt të kontratës, duke respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi për produktet biocide, mbrojtjen e shëndetit publik dhe mbrojtjen e mjedisit.

#### **Destinacioni i përdorimit:**

Produkti duhet të furnizohet në paketim origjinal të prodhuesit, të mbyllur dhe të etiketuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, në konfeksion plastik me kapacitet nga 1 (një) deri në 5 (pesë) litra, ose sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, në varësi të organizimit të shërbimit dhe nevojave operacionale.

Në momentin e lëvrimit, produkti duhet të ketë një afat të mbetur vlefshmërie jo më pak se 1 (një) vit, i llogaritur nga data e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor, me qëllim garantimin e ruajtjes së karakteristikave teknike dhe efektivitetit të tij gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

#### **Preparat për dezinfektim.**

Për garantimin e një programi efektiv të kontrollit të insekteve me rëndësi higjieno-sanitare në ambientet objekt të kontratës, vlerësohet i nevojshëm përdorimi i një preparati biocid insekticid të destinuar për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse, si milingona, miza, pleshta, rriqna, morra dhe dëmtues të tjerë të ngjashëm.

Preparati që do të përdoret duhet të jetë i autorizuar për përdorim në Republikën e Shqipërisë, i destinuar për përdorim profesional dhe i përshtatshëm për aplikim në ambiente të brendshme dhe të jashtme, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Produkti duhet të disponojë dokumentacionin teknik përkatës dhe të përdoret në përputhje me udhëzimet e prodhuesit, fletën teknike të produktit (Technical Data Sheet - TDS) dhe fletën e të dhënave të sigurisë (Safety Data Sheet - SDS).

---

Për realizimin e këtij shërbimi, lënda bazë aktive e preparatit duhet të jetë Deltamethrinë (CAS No. 52918-63-5), në përqendrim 2.5% – 3%. Gjithashtu, preparati duhet të ketë në përbërjen e tij minimumi një lëndë konservuese, me qëllim garantimin e stabilitetit dhe jetëgjatësisë së produktit gjatë periudhës së përdorimit, në përputhje me karakteristikat teknike të deklaruara nga prodhuesi.

Produkti duhet të furnizohet në paketim origjinal të prodhuesit, të mbyllur dhe të etiketuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, në konfeksion plastik me kapacitet 100 ml deri në 1 (një) litër.

Në momentin e lëvrimin, preparati duhet të ketë një afat të mbetur vlefshmërie jo më pak se 1 (një) vit, i llogaritur nga data e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor, me qëllim garantimin e ruajtjes së vetive fiziko-kimike dhe efektivitetit të produktit gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

### **Preparat për luftimin e minjve.**

Për garantimin e një kontrolli efektiv të brejtësve në ambientet objekt të kontratës, vlerësohet e nevojshme përdorimin e një preparati biocid rodenticid të përshtatshëm për luftimin e minjve në mjedis të hapura dhe të mbyllura.

Preparati që do të përdoret duhet të jetë i autorizuar për përdorim në Republikën e Shqipërisë, i destinuar për përdorim profesional dhe i përshtatshëm për aplikim në përputhje me kërkesat e shërbimit. Ky preparat duhet të jetë i tipit pellet, pastabite ose block.

Lënda bazë aktive e rodenticidit duhet të jetë Coumatetralyl (CAS No. 5836-29-3) me përqendrim 0.03% - 0.04%. Për të evituar kontaktin e rodenticidit me gjallesat e tjera, përveç minjve, si dhe për ta mbrojtur produktin nga agjentët atmosferikë, preparati duhet të jetë i veshur me një shtresë me veti hidhëruese, nëpërmjet përdorimit të lëndës aktive Bitrex (Denatonium Benzoate, CAS No. 3734-33-6) ose ekuivalentit të tij të destinuar për këtë qëllim.

Produkti duhet të furnizohet në paketim origjinal të prodhuesit, të mbyllur dhe të etiketuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, në konfeksion plastik me peshë 0.1 kg – 5 kg, i ndarë në copa me peshë 10 – 15 g secila.

Në momentin e lëvrimin, preparati duhet të ketë një afat të mbetur vlefshmërie jo më pak se 1 (një) vit, i llogaritur nga data e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor, me qëllim garantimin e ruajtjes së vetive fiziko-kimike dhe efektivitetit të tij gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

### **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Produktet biocide që do të përdoren duhet të sigurojnë efekt të shpejtë dhe efektiv dezinfektues, duke garantuar veprim baktericid, fungicid dhe virusicid të zgjatur, sipas karakteristikave teknike të deklaruara nga prodhuesi. Gjithashtu, ato nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që mund të rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedis, kur përdoren në përputhje me udhëzimet e prodhuesit dhe legjislacionin në fuqi.

---

Lëndët aktive të përcaktuara për produktet e dezinfektimit dhe deratizimit janë përzgjedhur duke marrë në konsideratë nevojën për garantimin e efektivitetit të vazhdueshëm të shërbimit dhe reduktimin e fenomenit të rezistencës së insekteve dhe brejtësve ndaj produkteve kimike të përdorura për periudha të gjata kohore.

Të gjitha produktet dhe preparatet objekt i këtij prokurimi duhet të furnizohen në paketimin origjinal të prodhuesit dhe të jenë të etiketuara në gjuhën shqipe, në përputhje me kërkesat e Kreut III “Komunikimi i rrezikut nëpërmjet etiketimit”, pika 1.2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 488, datë 29.06.2016, “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, i ndryshuar, me pikën 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 487, datë 29.06.2016, “Për klasifikimin e produkteve biocide”, si dhe me nenin 8 të Ligjit Nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.

## Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### Shërbimet që kërkohen:

Shërbimi i dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit ka për qëllim ruajtjen e kushteve optimale higjieno-sanitare në ambientet ku ushtron veprimtarinë shoqëria “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sha, parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së mikroorganizmave patogjenë, insekteve dhe brejtësve, si dhe mbrojtjen e shëndetit të personelit dhe përdoruesve të ambienteve.

#### Afatet e ekzekutimit:

Shpeshtësia e kryerjes së shërbimit do të jetë **3 (tre) herë në vit**, sipas planifikimit të Autoritetit Kontraktor, i cili do të vendoset pas lidhjes së kontratës. Në raste të veçanta, të lidhura me nevoja operationale, situata epidemiologjike ose vlerësime të riskut higjieno-sanitar, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kërkojë ndërhyrje shtesë, brenda fondit limit dhe sasive të parashikuara:

Nr.	Objekti	Sasia totale e shërbimeve (m <sup>2</sup> )	Shpeshtësia shërbimit (herë)	Afati i ekekutimit (muaj)
1	Stacioni i Sterilizimit pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë	655	3	12
2	Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Glozheni”, Tiranë	121	3	12
3	Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Universitar të Traumës	207	3	12
4	Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë	117	3	12
5	Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Rajonal Shkodër	165	3	12
6	Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Bashkiak “Ihsan Cabej” Lushnjë	243	3	12
7	Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Rajonal Durrës	157	3	12
8	Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Rajonal Vlorë	131	3	12

---

9	Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Bashkiak “Isa Zllami” Tropojë	44	3	12
10	Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Bashkiak Mat	31	3	12
11	Centrali i Sterilizimit pranë Spitalit Rajonal Dibër	107	3	12
12	Qendra e Logjistikës, Tiranë	2500	3	12

---

## Shtojca 8.

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

**Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:** Shërbimi i dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit ka për qëllim ruajtjen e kushteve optimale higjieno-sanitare në ambientet ku ushtron veprimtarinë shoqëria “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sha, parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së mikroorganizmave patogjenë, insekteve dhe brejtësve, si dhe mbrojtjen e shëndetit të personelit dhe përdoruesve të ambienteve.

#### Qëllimi i shërbimit

- a) Sigurimi i kushteve higjieno-sanitare në të gjitha ambientet e institucionit.
- b) Parandalimi i përhapjes së infeksioneve dhe mikroorganizmave patogjenë që mund të rrezikojnë shëndetin publik.
- c) Eliminimi dhe kontrolli i baktereve, viruseve dhe kërpudhave përmes proceseve të dezinfektimit.
- d) Kontrolli dhe eliminimi i brejtësve (minj, mi, etj.) përmes shërbimit të deratizimit.
- e) Kontrolli dhe eliminimi i insekteve fluturuese dhe zvarritëse (miza, mushkonja, buburreca, milingona, etj.) përmes shërbimit të dezinfektimit.
- f) Mbrojtja e shëndetit të personelit, pacientëve, vizitorëve dhe përdoruesve të institucionit.
- g) Ruajtja e standardeve të kërkuara të higjienës dhe sigurisë mjedisore në përputhje me legjislacionin dhe protokollet në fuqi.
- h) Ulja e rrezikut të infeksioneve spitalore dhe krijimi i një mjedisi të sigurt për ofrimin e shërbimeve.
- i) Kryerja periodike dhe sipas nevojës e trajtimeve DDD për të garantuar kontroll të vazhdueshëm të faktorëve biologjikë të dëmshëm.

**Detyrat:** Kryerja e shërbimit të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit të ambienteve të OSHIS me korrektësi dhe konform specifikimeve të kërkuara.

Shërbimi i dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit (DDD) duhet të kryhet në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi në fushën e shëndetit publik, mbrojtjes së mjedisit, sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe me praktikën e mira profesionale të kontrollit të dëmtuesve dhe dezinfektimit të ambienteve. Operatori ekonomik duhet të sigurojë që të gjitha aktivitetet e kryera të jenë në përputhje me kërkesat teknike dhe higjieno-sanitare të zbatueshme për institucionet publike dhe, në veçanti, për institucionet shëndetësore.

Të gjitha produktet biocide, dezinfektantët, insekticidet dhe rodenticidet që do të përdoren gjatë zbatimit të kontratës duhet të jenë të autorizuar për përdorim sipas legjislacionit në fuqi, të pajisura me dokumentacionin përkatës teknik dhe fletët e të dhënave të sigurisë (SDS/MSDS), si dhe të përdoren në përputhje me rekomandimet dhe udhëzimet e prodhuesit. Produktet e përdorura nuk duhet të paraqesin rrezik të pajustificuar për pacientët, personelin, vizitorët, pajisjet mjekësore dhe mjedisin.

Shërbimi duhet të realizohet duke zbatuar metoda dhe procedura që garantojnë eliminimin ose reduktimin në nivele të pranueshme të mikroorganizmave patogjenë, insekteve fluturuese dhe zvarritëse, si dhe brejtësve, në të gjitha ambientet objekt i kontratës. Gjatë kryerjes së ndërhyrjeve duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të personelit dhe përdoruesve të ambienteve, si dhe për shmangien e ndotjes së mjedisit.

---

Shërbimi duhet të bazohet në parimet e menaxhimit të integruar të dëmtuesve (Integrated Pest Management – IPM), duke synuar parandalimin, monitorimin dhe kontrollin efektiv të dëmtuesve, me përdorimin sa më racional të produkteve kimike dhe minimizimin e ndikimit në shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.

Shërbimi duhet të përfshijë inspektimin paraprak të ambienteve, identifikimin e problematikave ekzistuese, planifikimin e ndërhyrjeve, aplikimin e trajtimeve përkatëse, monitorimin e rezultateve dhe kryerjen e ndërhyrjeve shtesë kur ato vlerësohen të nevojshme.

Operatori ekonomik duhet të përdorë metoda dhe teknika që sigurojnë efektivitet maksimal të trajtimit, duke minimizuar ndikimin në aktivitetin normal të institucionit. Në rastet kur ndërhyrjet kërkojnë kufizimin e aksesit në ambiente të caktuara, operatori ekonomik duhet të koordinohet paraprakisht me Autoritetin Kontraktor.

Shërbimi i dezinfektimit duhet të synojë eliminimin ose reduktimin e mikroorganizmave patogjenë në sipërfaqe dhe ambiente, ndërsa shërbimi i deratizimit dhe dezinfektimit duhet të synojë kontrollin, reduktimin dhe eliminimin e brejtësve dhe insekteve nëpërmjet metodave të përshtatshme dhe të sigurta.

Operatori ekonomik duhet të kryejë monitorime periodike të pikave kritike dhe të evidentojë çdo shenjë të pranishme të dëmtuesve, duke propozuar masat korrigjuese dhe parandaluese të nevojshme për eliminimin e tyre.

Pas çdo ndërhyrjeje duhet të hartohet raport teknik, i cili duhet të përmbajë të paktën:

- datën dhe orën e kryerjes së shërbimit;
- ambientet e trajtuara;
- llojin e ndërhyrjes së kryer;
- produktet e përdorura dhe sasi të aplikuara;
- masat e sigurisë të zbatuara;
- konstatimet dhe rekomandimet përkatëse.

Operatori ekonomik duhet të jetë në gjendje të kryejë ndërhyrje të jashtëzakonshme, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, në rast të evidentimit të infestimeve ose situatave që paraqesin rrezik për shëndetin publik.

Gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, operatori ekonomik mban përgjegjësi për cilësinë dhe efektivitetin e shërbimit të ofruar, si dhe për respektimin e të gjitha kërkesave ligjore, teknike dhe të sigurisë që lidhen me objektin e kontratës.

Dezinfektimi duhet të kryhet në përputhje me nevojat specifike të ambienteve objekt trajtimi dhe ekspertizën higjieno-sanitare të operatorit ekonomik, duke përdorur metodologjitë dhe pajisjet e përshtatshme për secilin rast, si më poshtë:

- me spërkatje mjegulluese në të ftohtë, me presion shumë të ulët, e cila garanton shpërndarjen e grimcave të imta të preparatit dhe mbulimin 100% të ambientit, kryesisht në ambiente të vogla, zyra, automjete etj., duke përdorur pajisje të përshtatshme si pompa, çanta shpine me presion ose mjete të tjera ekuivalente;
- me spërkatje me presion të ulët, në një distancë minimale prej 2 (dy) metrash, e cila garanton shpërndarjen e grimcave të vogla të preparatit dhe mbulimin 100% të sipërfaqeve

---

objekt trajtimi, kryesisht për dysheme, mure të jashtme, mure rrethuese dhe sipërfaqe të tjera të ngjashme, duke përdorur pompa, çanta shpine me presion ose mjete lëvizëse të përshtatshme;

- me spërkatje me presion të ulët, në një distancë minimale prej 2 (dy) metrash, e cila garanton shpërndarjen e grimcave të vogla të preparatit dhe mbulimin 100% të sipërfaqeve të brendshme, si dysheme, mure, mobilie dhe elementë të tjerë të ambienteve objekt trajtimi, duke përdorur pajisjet përkatëse;
- me spërkatje mjegulluese në të ftohtë, me presion shumë të ulët, e cila garanton shpërndarjen uniforme të grimcave të imta të preparatit dhe mbulimin e plotë të ambientit, kryesisht në ambiente të vogla dhe automjete, nëpërmjet përdorimit të pompave, çantave të shpinës me presion ose pajisjeve të tjera të përshtatshme;
- me spërkatje mjegulluese në të nxehtë, në një distancë minimale prej 10 (dhjetë) metrash, kryesisht për trajtimin e rrugicave hyrëse-dalëse, shesheve të pushimit, holleve të hapura dhe sipërfaqe të tjera të jashtme, duke përdorur pompa, çanta shpine me presion ose mjete lëvizëse të destinuara për këtë qëllim.

Për produktet që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës, operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë, fletët e të dhënave të sigurisë (SDS/MSDS), si dhe dokumentacionin që vërteton autorizimin ose regjistrimin e tyre për përdorim sipas legjislacionit në fuqi. Dokumentacioni teknik duhet të përmbajë informacion mbi përbërjen, mënyrën e përdorimit, masat e sigurisë dhe efektivitetin e produkteve.

#### **Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:**

Shërbimi i dezinfektimit, deratizimit dhe dezinfektimit (DDD) do të kryhet në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jashtme që administrohen ose përdoren nga Autoriteti Kontraktor, sipas nevojave të institucionit dhe planit të miratuar të ndërhyrjeve. Objekt i shërbimit do të jenë të gjitha hapësirat funksionale të institucionit, përfshirë zyrat administrative, koridoret, shkallët, depot, magazinat, ambientet teknike, ambientet shëndetësore, pikat e grumbullimit të mbetjeve, si dhe hapësirat e jashtme si oborret, rrugët e brendshme dhe zonat e gjelbëruara.

Operatori ekonomik është i detyruar të kryejë inspektimin e ambienteve para fillimit të shërbimit dhe të organizojë ndërhyrjet në mënyrë të tillë që të garantohet vazhdimësia normale e aktivitetit të institucionit dhe të minimizohen pengesat gjatë kryerjes së trajtimeve. Shërbimi do të realizohet në të gjitha objektet dhe ambientet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor gjatë periudhës së zbatimit të kontratës, sipas programit të ndërhyrjeve periodike, si dhe në çdo ambient tjetër ku do të paraqitet nevoja për ndërhyrje të veçanta ose emergjente. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të përcaktojë, sipas nevojave operative, ambientet prioritare dhe zonat që do t'i nënshtrohen trajtimit gjatë periudhës së kontratës.

---

## Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

---

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 Operatori ekonomik, duhet të disponojë “Licencën profesionale Shërbime Ndërhyrëse Higjieno-Shëndetësore me Kod II.8.B (të vlefshme).

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme:

*(Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve të bashkimit duhet të disponojë këtë certifikatë):*

-ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent (e vlefshme), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

---

-ISO 45001:2018 (Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë) ose ekuivalent (e vlefshme), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent (e vlefshme), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

